

# Koment

## Per tatimin e Biznesit te vogel

Nisur nga shume debate, menduam te shprehim mendimet tona ne lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel.

Me poshte po citojme nenin per shkallen tatimore te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel.

**Ligji 9632, datë 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore”**

**Neni 11 Shkalla tatimore**

1. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5 për qind.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit.

(Ndryshuar me ligjin 142/2015 date 17.12.2015)

Pika e dobet qe behet objekt i diskutimeve, eshte fakti se **sa eshte tatimi** per tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 deri në 8 milionë lekë???

Ose e thene ndryshe, psh. nje tatimpagues **me qarkullim vjetor 6 milion leke si do te tatohet:**

- 6.000.000 leke x 5% = 300.000 leke tatim apo
- 5.000.000 leke x 0% = 0 leke tatim dhe
- 1.000.000 leke x 5% = 50.000 leke tatim

Bindja jone eshte per pjesen e dyte, por duke qene se kemi degjuar mendime te kunderta dhe jo te hijeshme, mbetet te presim udhezimin e ministrit duke shpresuar qe te jete ne koherence me ligjin si gjithmone, per te shmangur keqkuptimet dhe keqinterpretimet.

Çdo mendim tuajin do e mirepresim me respekt dhe kenaqesi.

**Sinqerisht**

**Luan Gosnishti**

**Ekspert Kontabel i Regjistruar**